



**BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 245/2 Prot

Rrëshen më, 30.01.2026

V E N D I M

Nr. 5 datë 26. 01. 2026

PËR

**“PËRCAKTIM PËRDORIMI FONDI (GRAND PËRFORMANCE), ME BURIM
FINANCIMI TË HUAJ”, BASHKIA MIRDITË**

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, ligji nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligji nr. 115/2024, “Për buxhetin e vitit 2025”, Udhëzimi e përbashkëta me nr. 20 & 01, datë 11.07.2025, të Ministrisë Financave dhe Ministrisë Shtetit për Pushtetin Vendor, “Pë kriteret, procedurat, treguesit për shpërndarjen e fondit të grandit, të bazuar në performancë për bashkitë, për vitin 2025”, në shkresën nr. 764 prot, datë 19.12.2025, të Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV), “Shkresë përcjellëse mbi vendimin përfundimtar të KVA-së në kuadër të GBP 2025”, relacionin nr. 245 prot, datë 15.01.2026, së bashku me projekt-vendimin dhe relacionin shtesë nr. 428 prot, datë 26.01.2026, paraqitur nga Kryetari i Bashkisë, shqyrtimin e miratimit në mbledhjen e datës 23.01.2026, të Komisionit Ekonomisë, Financës dhe Buxhetit, për t’a kaluar në mbledhjen e Këshillit Bashkiak, pas diskutimeve;

V E N D O S I:

1. Miratimin e përdorimit të fondit, grandit të performancës, me burim financimi të huaj, si më poshtë vijon;
 - a. Shuma e grandit;.....**1 666 639.78** (një milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e nëntë pik shtatëdhjetë e tetë) lekë
 - b. Ky fond të përdoret për shpenzime operative, pa përfshirë paga personeli dhe shpërblime, në llogarinë ekonomike **602**, kapitull **02 (financim i huaj)**, për **“Qendrën ditore për të moshuarit”** në Bashkinë Mirditë
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë; (Agjencia e Arsimit, Sportit dhe Ndihmës Sociale, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Tatim Taksave)

Ky vendim, hyn në fuqi, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë

SEKRETAR

Gaspër TOPOLLAJ

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al



ADRESA: SHEHCY "ABAT DOÇI", RRËSHEN

tel dhe fax: (00355) (0) 2162233

KRYETAR

Aleksandër PICAKU

www.bashkiamirdite.gov.al



BASHKIA MIRDITË

KËSHILLI I BASHKISË MIRDITË

Nr. 245 Prot

Data 15.01 /2026

P/V E N D I M

Nr. 4 date 15.01 .2026

PËR

“PËRCAKTIM PËRDORIM FONDI (GRAND PËRFORMANCE), ME BURIM FINANCIMIN E HUAJI”

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015" Për veteqeverisjen vendore", ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Ligjit 115/2024, "Per buxhetin e vitit 2025", udhëzimet e përbashkëta, të Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Shtetit për Pushtetin Vendorë numër 20, dhe 01, datë. 11.07.2025 "Për kriteret ,procedurat, treguesit për shpërndarjen e fondit të grandit të bazuar në performancë për bashkitë për vitin 2025", në shkresën e Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore nr.764 prot, datë.19.12.2025 "Shkresë përcjellëse mbi vendimin përfundimtar të KVA-së në kuadër të GBP 2025",

Këshilli i Bashkisë Mirditë pasi diskutoi rreth projektit të paraqitur nga Kryetari i Bashkisë;

V E N D O S I:

I-Përdorimin e fondit të grandit të performancës me burim financim i huaji si më poshtë:

a-Shuma e gandit për përdorim.....1 666 639 .78
(njëmiljonegjashtëqindgjashtëdhjetegjashtëmijëgjashtëqindetridhjetenëntëpikështatëdhjetetë).

b-Ky fond të përdoret për shpenzime operative(pa përfshirë paga personeli dhe shpërblime), *në llogarinë ekonomike 602, me kapitull 02(financim i huaji)*, për "Qendrën ditore për të moshuarit", në Bashkinë Mirditë.

II- Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

SEKRETARI

KRYETARI

Gaspër TOPOLLAJ

Aleksandër PICA KU

Paraqiten projekt

Dr.zhvill.ekon.tatim taksa:V.Gjoka

Pergj.sekt buxhet fin:F.fufi

Përgj.sekt juridik dhe prok:M.Topollaj

KRYETARI

Albert MËLYSHI

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN

tel dhe fax : (00355) (0) 2162233 www.bashkiamirdite.gov





BASHKIA MIRDITË

AGJENCIA E ARSIMIT SPORTIT DHE NDIHMËS SOCIALE

Nr. 245/11 Prot.

Rrëshen, më 15 . 01 .2026

RELACION PËR PROJEKT-VENDIMIN

PËR

**“PËRCAKTIM PËRDORIM FONDI (GRAND PERFORMANCE), ME BURIM
FINANCIMIN E HUAJ”**

Të nderuar anëtarë të Këshillit të Bashkisë Mirditë,

Në mbështetje të nevojave sociale të komunitetit dhe në funksion të përmirësimit të shërbimeve për kategorinë e të moshuarve (në mënyrë të veçantë atyre të vetmuar), paraqesim për shqyrtim dhe miratim kërkesën tonë:

Në kuadër të kësaj kërkesë, Shërbimi Social i Bashkisë Mirditë, paraqet pranë Këshillit të Bashkisë Mirditë kërkesën për përdorimin e fondit në vlerën 1,666,639.78 (një milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e nëntë pikë shtatëdhjetë e tetë) lekë, i cili do të shkojë për funksionimin dhe përmirësimin e shërbimeve të Qendrës Ditore për të Moshuarit. Ky fond do të shërbejë për:

- rritjen e cilësisë së shërbimeve sociale për të moshuarit;
- mbështetjen e aktiviteteve ditore psiko-sociale dhe rekreative;
- përmirësimin e kushteve dhe mjeteve të nevojshme për ofrimin e shërbimit.

Gjithashtu, theksojmë se realizimi i këtij projekti do të bazohet në **bashkëpunimin e Bashkisë Mirditë me organizata të shoqërisë civile (OJF)** që veprojnë në territorin e Bashkisë Mirditë, si p.sh. Vizion OJF, Mary War Loreto, Caritas Dioqezan Rrëshen, Mensa Dioqezane të cilat kanë eksperiencë në fushën e shërbimeve sociale dhe të mbështetjes së të moshuarve. Ky bashkëpunim synon rritjen e eficiencës, transparencës dhe qëndrueshmërisë së shërbimit.

Duke vlerësuar rëndësinë sociale të këtij shërbimi dhe ndikimin pozitiv që ka në përmirësimin e cilësisë së jetës së të moshuarve në komunitetin tonë, kërkojmë miratimin e Këshillit të Bashkisë Mirditë për përcaktimin dhe përdorimin e këtij fondi sipas qëllimit të mësipërm.

Ju falënderojmë për bashkëpunimin dhe mbështetjen tuaj!

Me respekt,

Konceptoi: Përgjegjës i Sekt.Soc. Gjergj Përgjoni

Miratoi: DREJTOR AASNS Aurel Çupi



KRYETAR

Albert MËLYSHI





BASHKIA MIRDITË
AGJENCIA E ARSIMIT SPORTIT DHE NDIHMËS SOCIALE

Nr. 428 Prot.

Rrëshen, më 26.01.2026

Lënda: Shtojcë relacioni

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë Mirditë

Nisur nga kërkesa e Komisionit të Ekonomisë për një informacion më të detajuar sa i përket Relacionit për “Përcaktim përdorim fondi (grand performance), me burim financimin e huaj”, ju bëjmë me dije se:

Në vijim të kërkesës së paraqitur pranë Këshillit të Bashkisë Mirditë për përdorimin e fondit prej 1,666,639.78 lekë (një milione gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë presje gjashtëqind e tridhjetë e nëntë pikë shtatëdhjetë e tetë), sqarojmë se qendra ditore për të moshuar do të ushtrojë aktivitetin e saj në ambientet e vendosura në Lagjen e Tërmetit, konkretisht në godinën e destinuar për kopsht të fëmijëve, e cila do të përshtatet për këtë qëllim.

Fondi i akorduar do të përdoret për përballimin e shpenzimeve të domosdoshme për funksionimin e qendrës, konkretisht për pagesën e shërbimeve si: ujë, energji elektrike, internet dhe televizion, si dhe për sigurimin e ushqimit, detergjentëve dhe materialeve të tjera të nevojshme për mirëmbajtjen dhe aktivitetin e përditshëm të qendrës.


Orari i funksionimit të qendrës, pa përfshirë shërbimin e transportit, do të jetë nga ora 09:00 deri në 12:30, periudhë gjatë së cilës të moshuarit do të përfshihen në aktivitete të ndryshme sociale dhe rekreative. Aktivitetet do të përfshijnë ofrimin e çajit ose kafesë gjatë momentit të pritjes në

mëngjes, aktivitete kreative, bashkëbisedime, ndjekje të programeve televizive, lexim librash dhe gazetash, si dhe vaktin e drekës.

Kjo shtojcë ka për qëllim sqarimin e mëtejshëm të kushteve të funksionimit dhe përdorimit të fondit të kërkuar.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

DREJTOR: Aurel Çupi



KRYETAR
Albert MËLLYSHI

